



UNIVERSITETI
UNIVERSITY
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Nr. 1280 dt. 10.05 2017

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Këshilli Drejtues

Ref. Nr. /2017

Pejë, 03.05.2017

Në bazë të nenit 17, nenit 23 pika 1.3, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 03.05.2017 nxori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për Zgjedhjet e Përgjithshme në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë
- II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Menaxhmenti i Universitetit.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të UHZ-së, ndërsa zbatimi i Rregullores nga pika 1 e këtij Vendimi do të bëhet nga shpallja e zgjedhjeve të përgjithshme në UHZ, nga ana e Këshillit Drejtues.

Vendimi i dërgohet:

- Rektorit
- Sekretarit të Përgjithshëm të UHZ-së
- Dekanëve të njësive akademike
- MASHT-it
- Arkivit të UHZ-së



Kryesuesi i Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Asoc. Dr. Zenun Halili



UNIVERSITETI
UNIVERSITY
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Nr. 1080 dt. 10.05.2017

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Në mbështetje të nenit 23 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Peje, si dhe në pajtim me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur me datë 03.05.2017, miratoi :

Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë

1. Dispozitat e përgjithshme
2. Rregullat zgjedhore
3. Listat e votuesve
4. Kandidatët
5. Regjistrimi i kandidateve
6. Komisioni Qendror Zgjedhor
7. Komisionet Zgjedhore të Fakulteteve
8. Dita e zgjedhjeve
9. Procedurat e votimit dhe fletëvotimet
10. Rezultatet e zgjedhjeve — hedhja e shortit
11. Periudha e ankesave

1. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

(1) Të gjitha rregullat dhe procedurat e mëtejme duhet t'i referohen dhe të bazohen në Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe aktet tjera normative në fuqi.

(2) Çdo ankesë kundër vendimeve të bazuara në këtë rregulla dhe procedura duhet të adresohen:

2.1. Kundër vendimit të komisionit zgjedhor, tek Komisioni Qendror Zgjedhor;

2.2. Kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor, tek Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 2

(1) Zgjedhjet si më poshtë do të mbahen në 5 fakultetet e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, sipas nenit 44 dhe 73 të Statutit:

1. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e profesorëve
2. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e asistentëve
3. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit jo-akademik
4. Anëtar i Senatit nga radhët e personelit akademik
5. Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit jo — akademik

(2) Zgjedhjet për anëtarë të Senatit nga radhët e personelit jo-akademik, siç është përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, do të mbahen edhe në Administratën Qendrore.

Neni 3

(1) Personeli akademik i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë përfshin grupet, siç ceket në nenin 167 paragrafi 2 të Statutit:

1. Profesor i rregullt
2. Profesor i asocuar
3. Profesor asistent
4. Asistente
5. Lektorë dhe korepetitorë

Neni 4

(1) Të gjithë mandatarët të cilët zgjedhën e mbajnë mandatin e tyre në përputhje me këto rregullore, Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" – Në Pejë dhe legjislacionit në fuqi.

(2) Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së kontratës, pensionimit, vdekjes, përjashtimit të mandatarit apo për shkak të ndonjë arsyeje tjetër, mandati do t'i takojë personit të parë të pazgjedhur sipas rezultateve të zgjedhjeve.

(3) Në rastet kur nuk ka persona në dispozicion nga rezultatet fillestare të zgjedhjeve mandatet do të mbeten të paplotësuara deri në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme.

Neni 5

(1) Personeli në marrëdhënie të rregullt pune, i cili është i zgjedhur apo emëruar në ndonjë institucion tjetër publik nuk ka të drejte për t'u zgjedhur në organe drejtuese, por ka të drejte për te votuar.

(2) Në rastet e kontestueshme në lidhje më të drejtën për të votuar ose të drejtën për kandidim, vendimi mund të ankimohet në Komisionin Qendror Zgjedhor.

(3) Për çdo vendim, arsyet duhet të jepen në forme të shkruar nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

1. Rregullat zgjedhore

Neni 6

(1) Anëtarët e këshillit të fakultetit nga radhët e profesorëve do të zgjidhen nga profesorët e këtij fakulteti siç përcaktohet në nenin 171 (profesor i rregullt), 172 (profesor i asocuar) dhe 173 (profesor asistent) të Statutit.

(2) Anëtarë të këshillit të fakultetit do të zgjidhen deri 15 profesorë.

(3) Në fakultetet ku numri i përgjithshëm i profesorëve - siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni nuk e kalon numrin 15, të gjithë profesorët të cilët regjistrohen për aplikim mandatohen automatikisht si anëtarë të këshillit të fakultetit. Në këso raste nuk do të mbahen zgjedhje.

Neni 7

(1) Anëtarët e këshillit të fakultetit nga radhët asistentëve do të zgjedhen nga personeli akademik i fakultetit siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

(2) Numri i asistentëve të zgjedhur në këshillin e fakultetit është më së shumti 32 (tridhjetë e dy) anëtarë.

(3) Në fakultetet ku numri i përgjithshëm i asistentëve, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, nuk e kalon numrin e cekur në paragrafin 2 të këtij neni, të cilët regjistrohen për aplikim automatikisht mandatohen anëtarë të këshillit të fakultetit. Në këso raste nuk do të mbahen zgjedhje.

(4) Në fakultetet ku numri i përgjithshëm i kandidateve asistente të regjistruar nuk tejkalon numrin e cekur në paragrafin 3 të këtij neni, të gjithë kandidatët e regjistruar automatikisht mandatohen si anëtarë të këshillit të fakultetit. Në këso raste nuk do të mbahen zgjedhje dhe mandatet do të mbesin të lira nëse nuk plotësohet numri.

Neni 8

(1) Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit akademik do të zgjedhën nga personeli akademik i secilit fakultet siç përcaktohet në nenet 171 (profesor i rregullt), 172 (profesor i asocuar), 173 (profesor asistent), 174 (asistent) të Statutit në fuqi.

(2) Një anëtar i personelit akademik nga secili fakultet zgjidhet anëtar i Senatit.

Neni 9

(1) Zyrtari për çështje juridike është anëtar ex-officio i këshillit të fakultetit pa të drejte vote.

(2) Një anëtar i personelit jo — akademik do të zgjidhet anëtar i këshillit të fakultetit.

Neni 10

(1) Një anëtarë i Senatit nga radhët e personelit jo — akademik do të zgjedhën nga personeli jo — akademik i të gjitha fakulteteve dhe i Administratës Qendrore të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, ashtu siç përcaktohet në Statut.

(2) Sekretari i përgjithshëm i universitetit është anëtar ex-officio i Senatit pa të drejte vote.

(3) Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit jo-akademik nuk mund të zgjedhën anëtare të Senatit.

(4) Në rast të votave të barabarta të kandidatëve për mandatin e dytë të renditur sipas listës prioritare të votave të fituara nën nr. rendor 2 dhe 3 nga lista e kandidatëve të votuar, përparësi do t'i jepet kandidatit të gjinisë femërore. Nëse asnjëri kandidat nuk është i gjinisë femërore atëherë përzgjedhja do të bëhet përmes hedhjes së shortit.

2. Lista e votuesve

Neni 11

(1) Administrata e fakulteteve dhe Administrata Qendrore e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ka për detyrë t'i ofrojë të dhënat e kompletuara të votuesve me të drejte vote Komisionit Qendror Zgjedhor.

(2) Në rast të vonesës ose refuzimit për të dorëzuar të dhënat nga ndonjë fakultet, do të merren masa disiplinore nga ana e Këshillit Drejtues të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, pas njoftimit nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Neni 12

(1) Lista e votuesve më të drejte vote do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin nga 5 fakultetet dhe administratën qendrore, duke përfshirë të dhënat në vijim:

Personeli akademik:

a) Numri rendor

- b) Emri
- c) Mbiemri
- d) Data e lindjes
- e) Thirrja akademike
- f) Fakulteti

Personeli jo akademik:

- a) Numri rendor
- b) Emri
- c) Mbiemri
- d) Data e lindjes
- e) Pozita
- f) Fakulteti / Administrata qendrore

3. Kandidatët

Neni 13

(1) Secili anëtar i personelit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ka të drejte të regjistrohet si kandidat për mandatin e caktuar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe statutit në fuqi.

(2) Anëtarët në Komisionin Qendror Zgjedhor nuk mund të kandidohen për mandate në autoritete kryesore qeverisëse sipas statutit në fuqi.

(3) Anëtarët e komisionit zgjedhor të fakultetit mund të kandidojnë në zgjedhjet e përgjithshme për të gjitha nivelet.

(4) Votuesit më të drejte vote kanë të drejte të regjistrohen për më shumë se një mandat.

(5) Në qofte se një anëtar i personelit zgjidhet në më shumë se një organ drejtues në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, kandidati përcaktohet se në cilin organ drejtues do të ushtrojë mandatin.

4. Regjistrimi i kandidatëve

Neni 14

(1) Çdo person më të drejte vote ka të drejte të regjistrohet si kandidat për ndonjë mandat që është caktuar sipas kësaj rregulloreje, përveç rasteve të cekura në nenin 5 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje.

(2) Procedurat e regjistrimit përgatiten për secilin fakultet.

(3) Komisioni zgjedhor i fakultetit duhet të caktojë një periudhë për regjistrim prej orës 08.00 dhe 14.00 gjatë ditës së regjistrimit, datë e cila do të shpallet nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

(4) Dita e regjistrimit duhet të jetë së paku 2 ditë para ditës së zgjedhjeve.

(5) Votuesit me të drejte vote të cilëve u pamundësohet pjesëmarrja në procedurat e regjistrimit duhet t'iu jepet mundësia të regjistrohen përmes aplikacioneve të shkruara.

(6) Një formular përkatës për regjistrim, shtojca 1, do të jetë në dispozicion në dekanate dhe në faqen e internetit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Pas plotësimit formulari dorëzohet në e-mailin e zyrtarit për çështje juridike të fakultetit përkatës.

Neni 15

(1) Komisioni Qendror Zgjedhor është i obliguar të kontrollojë çdo regjistrim të kandidaturës për vlefshmëri, duke iu referuar listës së votuesve dhe dispozitave të këtyre rregullave dhe procedurave.

(2) Lista zyrtare e kandidatëve do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin fakultet dhe administratën qendrore duke përfshirë të dhënat në vijim:

Personeli akademik:

- a) Numri rendor
- b) Emri
- c) Mbiemri
- d) Data e lindjes
- e) Numri i letërnjoftimit
- f) Thirrja akademike
- g) Fakulteti

Personeli jo-akademik:

- a) Numri rendor
- b) Emri
- c) Mbiemri
- d) Data e lindjes
- e) Numri i letërnjoftimit
- f) Pozita
- g) Fakulteti/ Administrata qendrore

(3) Lista zyrtare e personelit që kandidohen së paku një ditë para zgjedhjeve do të publikohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor në dekanatet e fakulteteve dhe në web faqen e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

5. Komisioni Qendror Zgjedhor

Neni 16

(1) Komisioni Qendror Zgjedhor do të përmbushe obligimet e veta, sipas Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe rregulloreve në fuqi.

Neni 17

(1) Secili anëtar i personelit ka të drejte të ankohet kundër vendimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor sipas nenit 1 paragrafi 2.2. Vendimi lidhur më ankesën duhet të merret brenda dy ditëve të punës pas pranimit të ankesës. Vendimi i Këshillit Drejtues është përfundimtar.

6. Komisionet Zgjedhore të Fakulteteve

Neni 18

(1) Secili Komision Zgjedhor i Fakultetit (KZF) përbëhet nga tre anëtare:

1. Zyrtari për çështje juridike, kryesues i komisionit zgjedhor;
2. Një profesor i fakultetit, i nominuar nga këshilli i fakultetit;
3. Një asistent i fakultetit, i nominuar nga këshilli i fakultetit.

(2) Zgjedhja e dy anëtareve tjerë të KZF nga radha e stafit akademik bëhet më shumice absolute (50 % +1) të numrit të përgjithshëm të anëtareve të këshillit të fakultetit përmes votimit të fshehtë.

(3) Nëse asnjë kandidat pas votimit të pare nuk ka marrë shumicën absolute të votave, në votimin e dytë zgjidhen kandidatet që kanë marrë më së shumti vota.

(4) Procesverbalet e komisionit të zgjedhjeve duhet të nënshkruhen nga kryesuesi dhe anëtarët e KZF.

(5) Mbledhjet e komisionit zgjedhor të fakultetit thirren nga kryesuesi i KZF me pëlqimin e Komisionit Qendror Zgjedhor.

7. Dita e zgjedhjeve

Neni 19

(1) Këshilli Drejtues shpalle datën e zgjedhjeve të përgjithshme.

(2) Në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet duhet të hapen nga ora 08.00 deri ne 16.00.

Neni 20

(1) Votuesit më të drejte vote duhet që personalisht të hedhin votën në kutinë e votimit të vendvotimit të fakultetit përkatës.

(2) Asnjë votues nuk ka të drejt të votojë në më shumë se një vendvotim.

Neni 21

Komisioni Qendror Zgjedhor në bashkërendim më komisionet zgjedhore të fakulteteve duhet të shpallin lokacionin e vendvotimeve.

Neni 22

(1) Zgjedhjet duhet të mbahen nga komisionet zgjedhore të fakulteteve, nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror Zgjedhor.

(2) Zgjedhjet mund të monitorohen nga institucione, organizata dhe palët tjera të interesit në përputhje me nenin 3 të kësaj rregulloreje.

8. Procedurat e votimit dhe fletëvotimet

Neni 23

(1) Gjatë kohës së votimit, së paku dy anëtare të komisionit zgjedhor të fakultetit duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës për të siguruar mbarëvajtje të rregullt të procedurave zgjedhore.

(2) Komisioni zgjedhor i fakultetit duhet të ndërmarre këto masa procedurale për mbarëvajtje të zgjedhjeve:

- a) Hapja dhe mbyllja e vendvotimit në kohën e caktuar dhe mbajtja e vendvotimit hapur gjatë periudhës së caktuar të zgjedhjeve;
- b) Ofrimi i materialeve të nevojshme për votime;
- c) Shpërndarja e materialeve zgjedhore;
- d) Shënimi i procedurave të votimit në protokollin e komisionit zgjedhor;
- e) Vulosja e kutive të votimit;
- f) Shënimi i numrit të fletëvotimeve dhe numërimi i votave;
- g) Shënimi i rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 24

(1) Procedura zgjedhore zhvillohet sipas ecurisë në vijim:

- a) Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi të identifikohet më dokument të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, patentë shoferi);
- b) Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi që të identifikohet më një nga kategoritë e personelit;
- c) Komisioni i zgjedhjeve e gjen votuesin në listën e votuesve;
- d) Komisioni zgjedhor kërkon nga votuesi të nënshkruhet në listën e votuesve;
- e) Komisioni zgjedhor i jep votuesit fletëvotimet e duhura;
- f) Votuesi votën në kabinën e votimit;
- g) Komisioni zgjedhor zëvendëson një fletëvotim sipas kërkesës nëse votuesi e ka dëmtuar atë;
- h) Votuesi e hedh fletëvotimin në kutinë e votimit;
- i) Votuesi del nga vendvotimi menjëherë pas votimit;

j)Komisioni zgjedhor shënon në protokoll çdo ndryshim të këtyre procedurave.

Neni 25

(1) Secili fletëvotim duhet të përmbajë emrat e të gjithë kandidatëve të cilët janë regjistruar për mandate të caktuara. Kandidatët radhitën në fletëvotim sipas alfabetit me emër dhe mbiemër.

(2) Secili votues ka të drejte të votojë në fletëvotim aq kandidatë sa edhe ka mandate në konkurrim në zgjedhjet e caktuara. Një lajmërim i përshtatshëm duhet të jepet në fillim të fletëvotimit.

(3) Fletëvotimet janë të vlefshme kur maksimumi i kandidatëve të paracaktuar ose më pak — siç ceket në fletëvotim janë votuar.

(4) Fletëvotimet nuk janë të vlefshme kur votohen më shumë mandate sesa maksimumi i përcaktuar — siç ceket në fletëvotim — ose kur nuk votohet asnjë kandidatë.

(5) Në të gjitha rastet e tjera të kontestimit të vlefshmërisë së fletëvotimit, vendimi mund të ankimohet në Komisionin Qendror Zgjedhor sipas kërkesës së komisionit zgjedhor të fakultetit.

Neni 26

Secili votues më të drejte vote ka të drejte të dorëzojë ankese në lidhje më procedurat e zgjedhjeve tek Komisioni Qendror Zgjedhor. Formulari përkatës, shtojca 2 do të jetë në dispozicion në secilin vendvotim në fakultete dhe në web faqen e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

9. Rezultatet e zgjedhjeve — hedhja e shortit

Neni 27

(1) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i obliguar të shpalle rezultatet zyrtare të zgjedhjeve brenda 24 orëve pas mbylljes së vendvotimeve.

(2) Në rastet kur dy ose më shumë mandate kanë marre numrin e njëjtë të votave, atëherë duhet të organizohet hedhja e shortit nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që do të vendos për ndarjen përfundimtare të mandateve.

(3) Ky short duhet të organizohet brenda 48 orëve pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve në prani të kandidatëve.

10. Periudha e ankesave

Neni 28

(1) Pas shpalljes zyrtare të rezultateve preliminare, shpallet një periudhe prej dy ditë pune për ankesa.

(2) Gjate kësaj periudhe mund të dorëzohen ankesa me shkrim në lidhje më procedurat e zgjedhjeve, rezultatet e votimeve dhe mandatarët.

(3) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosë për të gjitha ankesat brenda periudhës prej dy ditëve pas mbylljes së afatit të ankesave.

(4) Pas përfundimit të periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 dhe 3 te këtij neni, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 22

- (1) Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues.
- (2) Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e jep Këshilli Drejtues i UHZ-së.
- (3) Dispozitat e kësaj Rregulloreje në tërësi zbatohen për zgjedhjet e përgjithshme në UHZ, të cilat fillojnë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 23

Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, si dhe me aktet e tjera normative.

Neni 24

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në të njëjtën mënyrë në të cilën është miratuar kjo rregullore.

Kryetari i Këshillit Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë
Prof. Asoc. Dr. Zenun Halili

